



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT  
ZYRA E PËRMBARIMIT TIRANË

Nr. 12208 Prot

Tiranë, më 10 / 10 / 2023

**VENDIM**  
**PËR SHPALLJEN E SHITJES NË ANKAND**

Unë **Albert FEJZO**, Përmbarues Gjyqësor Pranë Zyrës Përmbarimore Tiranë pasi u njoha me materialet e dosjeve përmbarimore bazuar në Urdhërat e Ekzekutimit me Nr. 5875, Dt. 16/09/2021, Datë. 08.07.2013 dhe Nr. 5027, Dt. 05/10/2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

**KONSTATOVA:**

Se është depozituar pranë Zyrës së Përmbarimit Tiranë kërkesa e kreditorëve së bashku me “Urdhëriat e Ekzekutimit” lëshuar për vendimet me Nr. 5875, Datë. 16.09.2021 dhe Nr. 5027, Datë. 05.10.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me palë dhe objekt:

**Kreditor: Fatmir Hoxha, Artan Çerma**

**Debitor: Shoq “JON” sh.p.k me NIPT K52010004J**

**Objekt: Kthim Shume**

Në kushtet kur në zbatimin e K.Pr.Civile dhe për ekzekutimin e titujve ekzekutivë të mësipërm, është vendosur masa e sekuestros mbi pasuritë objekt ekzekutimi në favor të kreditorëve Fatmir Hoxha dhe Artan Çerma si garanci për kthimin e shumave, konkretisht për shumën 3,779,346 lekë për Fatmir Hoxha dhe 2,708,425 lekë për Artan Çerma; në pronësi të **Shoq “JON” sh.p.k me NIPT K52010004J** dhe konkretisht mbi pasurinë e palës debitore:

-Nr. i pasurisë 215/223+1-15, Zona Kadastrale Nr. 3866 me sipërfaqe 130 m2.

me adresë Rr: “Sabri Preveza” Pallati i shoqërisë “JON” sh.p.k pranë Unazës Re, Tiranë.

Me shkresën Nr. 11306, Dt. 28.09.2023 sipas nenit 567 të Kodit të Procedurës Civile, është njoftuar debitori për ekzekutimin e detyrimit brenda afatit 10 (dhjetë) ditor dhe në rast se nuk përmbushet detyrimi brenda këtij afati, në bazë të nenit 568 të Kodit të Procedurës Civile, do të shpallet shitja në ankand e pasurive.

Sipas akteve të administruara në dosjen përmbarimore, nuk rezulton të jetë përmbushur detyrimi nga debitori Shoqëria “JON” sh.p.k me NIPT K52010004J.

*Për këtë arsye, në mbështetje të nenit 567, 568, 569 e 570 të Kodit të Procedurës Civile, unë përmbarues gjyqësor Albert Fejzo*

**V E N D O S A:**

**1. Shpalljen e shitjes në ankand të pasurisë:**

-Nr. i pasurisë 215/223+1-15, Zona Kadastrale Nr. 3866 me sipërfaqe 130 m2 në vlerën 7,176,000 lekë,


me adresë Rr: “Sabri Preveza” Pallati i shoqërisë “JON” sh.p.k pranë Unazës Re, Yzberisht, Tiranë

2. Shitja e pasurisë në ankand do të bëhet ditën e **Premte** me datë **27.10.2023**, ora **16.00**, në Zyrën e Përmbarrimit Tiranë.
3. Çdo ofertues që është i interesuar për blerjen e pasurisë/pasurive në ankand, është i detyruar të paraqitet personalisht dhe/ose nëpërmjet përfaqësuesi të tij/saj me prokurë, si dhe **të dorëzojë (brenda në zarf të mbyllur) në zyrën e përmbarruesit gjyqësor deri në orën 16:00, këto dokumenta:**
  - a) kërkesën e tij/saj për pjesëmarrje në ankand;
  - b) faturën bankare të 10% të garancisë për pjesëmarrje në ankand (në origjinal);
  - c) dokumentin e identifikimit (Kartë identiteti ose Pasaportë).Në rast se ofertuesi është person juridik, përveç dokumenteve që paraqet çdo person fizik, përfaqësuesi ligjor duhet të paraqesë statusin, aktin e themelimit të personit juridik, një kopje të ekstraktit historik të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, si dhe një kopje të certifikatës së regjistrimit dhe/ose dokumente të tjera që parashikon ligji "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
4. Çdo ofertues që merr pjesë në ankand, përpara fillimit të procedurave të shqyrtimit të ofertave, në ditën e **Premte** me datë **27.10.2023**, është i detyruar të depozitojë si garanci pranë Bankës "Credins", Tiranë në Nr. Llogarisë me IBAN: AL61 2121 1016 0000 0000 0081 8181 së Zyrës së Përmbarrimit Tiranë një shumë të hollash të barabartë me 10 % të çmimit të pasurisë/pasurive të caktuar në shpallje. Kreditori nuk le garanci, në rast se kredia e tij e kalon masën e garancisë.
5. Debitori dhe/ose përfaqësuesi i tij ligjor, përmbarruesi gjyqësor, si edhe personat e tjerë që listohen në nenin 709 të Kodit Civil, nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ankand. Kur sendi blihet nga një person që nuk ka të drejtë të marrë pjesë në ankand, shitja është e pavlefshme. Në këtë rast, shuma e lënë si garanci nga blerësi kalon në dobi të shtetit dhe sendi me kërkesë të secilit kreditor mund të shitet përsëri në ankand, duke vepruar sipas rregullave të caktuara në Kodin e Procedurës Civile.
6. **Gazeta "Panorama"** dhe **Gazetën "Shqiptare"**, sipas detyrimit që rrjedh nga neni 568 i Kodit të Procedurës Civile, këtë vendim detyrohen ta publikojnë **5 (pesë) ditë me radhë**, në gazetat e tyre. Për shërbimin e kryer, pala kreditore merr persiper pagimin e shumës e cila më pas sipas nenit 525 do ti llogaritet palëve debitore.
7. Pala kreditore duhet të paraqesë tek përmbarruesi gjyqësor një kopje të faqeve të gazetave të cilat kanë publikuar vendimi **5 (pesë) ditë me radhë**.

Ky vendim hartohet në **9 (Nëntë)** kopje. Një kopje administrohet në dosjen përmbarrimore **1 (një)** kopje afishohet në ambientet e Zyrës e Përmbarrimit Tirane; **1 (një)** kopje afishohet në vendin ku ndodhen pasuritë e paluajtshme; **1 (një)** kopje i njoftohet debitorit; **1 (një)** kopje i njoftohet kreditorit; **2 (dy)** kopje iu njoftohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane dhe Bashkisë Tiranë, për afishim në ambientet e tyre publike, si dhe **2 (dy)** kopje iu njoftohen për publikim **Gazetës "Panorama"** dhe **Gazetës "Shqiptare"**.

**PËRMBARRUESI GJYQËSOR**

**Albert FEJZO**



Adresa: Sheshi "Mustafa Qemal Atatürk", Tiranë

Tel: 04271756